

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nufi: Industria e mbrojtjes prioritet strategjik, gjashtë sipërmarrje të përbashkëta me kompani ndërkombëtare
ADRESA	https://kohajone.com/politike/nufi-industria-e-mbrojtjes-prioritet-strategjik-gjashte-si-permarrje-te-perbashketa-me-kompani-nderkombetare/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 13:46:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 13:44:14 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3955c1913a336022c0b5bca458997fc0cb8db3fcad45ad9941b63bd58ec9f72f
TEKSTI	10203d5a6df971f3d6a046e82abb17bece55307ad002e513b65c118c9b23ec19
PAMJA	4a02fbcfffb96b7c3140afa9f9d99dcc7963dfcfc3b16bbf093e1416b3e78ff48

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3dc3b74cd87126cb95da6462a2d7849424581bc6bb7010601901cec3920d8dda
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	cefaef77fae8127be4f6b3fffc05035f4622ba050d1097e673137ff6e41f5a68
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3dc3b74cd87126cb95da6462a2d7849424581bc6bb7010601901cec3920d8dda>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px


Nufi: Industria e mbrojtjes prioritet strategjik, gjashtë sipërmarrje të përbashkëta me kompani ndërkombëtare

LAJME POLITIKE E DIEL, 13 SHTATOR 2026 15:44



Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi e cilëson zhvillimin e industrisë së mbrojtjes si një prioritet strategjik për Shqipërinë.

Përmes një videomesazhi, ai cilëson se vendi ka hyrë tashmë në një fazë të re, ku industria e mbrojtjes synon të rrisë sigurinë kombëtare, kapacitetet teknologjike dhe zhvillimin ekonomik.



"Zhvillimi i industrisë së mbrojtjes në Republikën e Shqipërisë dhe çdo hap që lidhet me të, mbetet përherë një lajm i mirë për vendin tonë. Përkundër fantazisë, trillimeve dhe akuzave politike të faktorëve që duan të ushqejnë veten dhe të mbijetojnë në rrugën që kanë humbur, sot asgjë nuk e ndal faktin se zhvillimi i industrisë së mbrojtjes është një prioritet strategjik për Shqipërinë, prioritet, i cili është në funksion të sigurisë kombëtare, ashtu edhe të angazhimeve tona si një vend anëtar i NATO-s. Shqipëria ka hyrë tashmë në një fazë të re, ku industria e mbrojtjes nuk e sheh më veten si një çështje e vetme sigurie, por si një mundësi strategjike për zhvillimin ekonomik, teknologjik dhe industrial të vendit", u shpreh ministri Nufi.



Përmes kompanisë shtetërore KAYO, thotë më tej, Ministri i Mbrojtjes, po zhvillohen aktualisht 6 sipërmarrje të përbashkëta me kompani ndërkombëtare, ndërsa në inventarin e Forcave të Armatosura kanë hyrë 40 mjetet e para të prodhuara në Shqipëri.

"Nëse për shumë vite me radhë, kjo industri u trajtua si një trashëgimi "për t'u shkatërruar", ne sot po e ndërtojmë dhe fuqizojmë atë me kapacitete drejt së ardhmes. Përmes kompanisë shtetërore KAYO, themeluar në vitin 2024, po

LAJMET KRYESORE



Opinion nga Elvin BLAKAJ:
"Jam mysliman" të Ben BLUSHIT e kam lexuar katër herë



Radio "Europa e Lirë": Si po përdoret IA-ja për sigurinë në shkollat e Shqipërisë



I rikthehet sërish pagave të gjyqtarëve, Rama: Marrin 280% më shumë se administrata, gati 2 mijë euro mbi pagën e Presidentit



Gjergj Luca inauguron "Rozafa Fier", një investim i ri pranë Apolonisë



Edhe një tentim për konstituim të parlamentit të Kosovës, PDK-ja s'merr pjesë

TË PËRZGJEDHURA



Edmond Spaho te Nikoll Lesi: PD ka mbaruar, nuk vjen ne pushtet!



Luka Modric konfirmon pjesëmarrjen me Kroacinë në Ligën e Kombeve



Dëshirat e Spallettit dhe blerjet e Juventus-it



Tesla, drejtimi gjysmë-autonom drejt përshtatjes me rregullat evropiane, thotë Franca



Shpërthen Erion Braçe te Nikoll Lesi në KOHA JONË-DEBAT: Nuk votoj kandidat me "njoftim"!

MË TË LEXUARAT

ndërtojmë një partneritet me kompani lidere ndërkombëtare. Sot janë në zhvillim gjashtë sipërmarrje të përbashkëta – joint venture, nëpërmjet partneritetit publik-privat, ku KAYO bën pjesë. Në inventarin e Forcave të Armatosura kanë hyrë tashmë 40 mjetet e para të prodhuara dhe shumë shpejt do të fillojmë edhe prodhimin e municionit të lehtë”, theksoi më tej Nufi.

Ndër të tjera, ai u ndal edhe Fincantieri Albania dhe tek prodhimi i pajisjeve individuale mbrojtëse për Forcat e Armatosura dhe institucionet e tjera të sigurisë:

“Me Fincantieri Albania, falë partneritetit me një lider prestigjioz të prodhimit të anijeve, nuk po blejmë thjesht anije: po fuqizojmë aftësitë shqiptare për të ndërtuar këtu, për të prodhuar për veten dhe për të eksportuar tek vendet e tjera aleate. Pajisjet individuale mbrojtëse, për Forcat e Armatosura dhe institucionet e sigurisë, produkte që deri dje importoheshin, tashmë do të prodhohen në Republikën e Shqipërisë sipas standardit më të lartë ndërkombëtar”, nënvizoi ministri Nufi.

Kjo industri, theksoi Nufi, nuk duhet të shihet vetëm si një çështje sigurie, por edhe si një mundësi për punësim, teknologji, prodhim vendas dhe zhvillim ekonomik.

“Këto janë vetëm hapat e parë, hapa që pas 17 vitesh si përfutuese e sigurisë së Aleancës, Shqipëria po i shndërron gjithnjë e më shumë në hapa konkretë për të qenë kontribuuese e saj faktike. Dhe ky është një fakt që duhet të bëjë krenarë të madh e të vogël; të majtë e të djathtë. Nëse për dekada me radhë, mbrojtja ishte një faturë, sot po ndërtojmë një industri specifike të lidhur më të! Një industri që prodhon siguri, teknologji, kapacitete dhe që gjeneron punësim, edhe këtu në Shqipëri garanton që kemi kapacitetet e duhura për sigurinë e vendit”, përfundon mesazhin e tij Nufi.

MË SHUMË NGA LAJME



Berisha: Udhëtimi në SHBA, ripërtëritës i jetës time!



Rama: Kemi gjithnjë e më pak mësues, profesori i matematikës drejt “h...



Pagat e magjistratëve/ Rama: Të gjithë duhet të respektojnë Kushtetut...



I rikthehet sërish pagave të gjyqtarëve, Rama: Marrin 280% më shumë s...



PISA 2025/ Rama: Nga fundi në krye, Shqipëria sot e para në matematikë




Pagat e gjyqtarëve/ Rama: Në Shqipëri gjyqtari fillestar paguhet 500 ...

LAJMET E FUNDIT



Nufi: Industria e mbrojtjes prioritet strategjik, gjashtë sipërmarrje të përbashkëta me kompani ndërkombëtare

[27 SEKONDA MË PARË](#)



Messi nuk di të ndalet, shënon golin e 928 në karrierë (VIDEO)

[5 MINUTA MË PARË](#)



Alarm në qiellin e Lituanisë: NATO ngre avion luftarak pas dyshimit për një dron mbi Vilnius

[21 MINUTA MË PARË](#)





Adeyemi sillet si dhëndër kosovar, shkon në stërvitje te Barcelona me targat e Kosovës

38 MINUTA MË PARË



Kur Nënë Tereza, shërbestarja që hyjnoi mëshirën, vinte të puthte tokën e shpirtit që e shenjtëroi

32 MINUTA MË PARË



Berati përkuqton 82-vjetorin e Çlirimit, homazhe në Varrezat e Dëshmorëve

1 ORË E 24 MINUTA MË PARË

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

KOHA JONE

Gazeta "KOHA JONË" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991

Botues: Nikoll LESI. Adresa e redaksisë: Rruga "Sami Frasheri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

EKONOMI

EDITORIAL

WEBTV

AKTUALITET

RAJONI

KOSOVA

BOTA

TEKNOLOGJI

SHOWBIZ

SHËNDETI

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

KULTURA

HISTORIKU

KONTAKT

BOTUES & DREJTOR: Nikoll LESI

KRYEREDAKTOR: Daniel MUÇAKU

ZV/KRYEREDAKTOR: Redjon SHTYLLA

BORDI: Elsa KAMBERI, KRYETARE

NIPT: J71425013C



NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA



© 2024 KOHA JONE. All rights reserved.

PRIVACY POLICY

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.